



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 29, datë 30.03.2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E SHOQËRISË “EUROTRADE SECURITIES” SH.A., PËR TË VEPRUAR  
SI AGJENT BROKERI NË LETRAT ME VLERË, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË  
SHOQËRISË “LEADCAPITAL MARKETS” LTD**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 42, pika 10, të Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, si dhe të Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 55, datë 30.03.2011, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shoqërisë “Eurotrade Securities” sh.a., për të vepruar si agjent brokeri në letrat me vlerë, në emër dhe për llogari të shoqërisë “LeadCapital Markets” Ltd, e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e Qipros.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV**  
**Mimoza KAÇI**